



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 27.12.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1637_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 pika 1.2 dhe paragrafi 7 pika 7.2, Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafin 1.2, Nenit 28 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 pika 1.49 dhe pika 1.76, Nenit 22 paragrafi 7 dhe Neni 23 paragrafi 5, dhe paragrafi 9, pikat 9.3, 9.13, 9.15 dhe 9.16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 2.1.2 paragrafi (a) pika (x), dhe Nenit 11.5.2 të Rregullave të Tregut, të miratuara me Vendimin e ZRRE nr. V_1066_2018 të datës 30/10/2018;
- Dispozitat e Nenit 3.5 të Licencës së Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike të lëshuar KOSTT SH.A, me numer Licence: ZRRE/Li_16/17;
- Memorandumin e Mirëkuptimi (MeM) për të koordinuar aktivitete për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë, si hap i parë për integritet rajonale të tregut të energjisë, nënshkruar në prill 2014 nga Ministritë përkatëse të Kosovës dhe Shqipërisë;
- Memorandumin e Mirëkuptimit të Ballkanit Perendimor 6, të nënshkruar në Vjenë me 27 prill 2016 për Zhvillimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike, nënshkruar nga Shqipëria dhe që Kosova ka shprehur gadishmëri për ta zbatuar;
- Memorandumin e Mirëkuptimit për Themelimin dhe Funkcionalizimin e Bursës së Energjisë Elektrike nënshkruar në nëntor 2017 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës;
- Marrëveshjes Kornizë për Bashkimin e Tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, të nënshkruar me 21 tetor 2021, ndërmjet ZRRE, ERE, KOSTT dhe OST;
- Themelimin e ALPEX sh.a, në të cilën KOSTT është aksionar dhe me të drejta të plota;
- Regjistrimin e Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a-Degës në Kosovë;
- Vendimit të ZRRE nr.1332_2020, për Aprovim në parim të kërkesës së OT/KOSTT SH.A për transferim e disa të drejtave dhe përgjegjësi që kanë të bëjnë me organizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike një ditë para dhe brenda ditës, tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX).
- Marrëveshjen për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut sh.a (KOSTT) tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX), për organizimin e tregut një ditë para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimit përfundimtar, të nënshkruar me 16 dhjetor 2022;



- Kërkesës se KOSTT për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT sh.a. tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-Dega në Kosovë (ALPEX) për organizimin e tregut një ditë para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimit përfundimtar për territorin e Republikës së Kosovës, të dates 19.12.2022;

në seancën e përbashkët publike me Bordin e Entit Regullator të Energjisë (ERE) të Republikës së Shqipërisë të mbajtur me datë 27.12.2022, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** transferimi i të drejtave dhe detyrimeve për organizimin e tregut një ditë para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimit përfundimtar nga Operatori i Tregut/KOSTT sh.a tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX).

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 19.12.2022 ka pranuar nga Operatori i Tregut/KOSTT SH.A. Kërkesën për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga OT/KOSTT sh.a. tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX) për organizimin e tregut një ditë para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimit përfundimtar për territorin e Republikës së Kosovës.
- o Kërkesa e KOSTT është mbështetur në: dispozitat e Nenit 22 paragrafi 7 dhe Neni 23 paragrafi 5 dhe paragrafi 9 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085), dispozitat e Nenit 2.1.2 paragrafi (a) pika (x) , dhe Neni 11.5.2 të Rregullave të Tregut, të datës 30/10/2018, dhe dispozitat e Nenit 3.5 të Licencës së Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike të lëshuar KOSTT SH.A, me numer Licence: ZRRE/Li_16/17;
- o Kërkesa e cekur më lartë me mbështetjen ligjore të bërë nga KOSTT, ka ardhur si rezultat i procesit për krijimin e një tregu të përbashkët të energjisë elektrike mes Kosovës dhe Shqipërisë, e të cilit proces i kanë parapri edhe Marrëveshjet si në vijim:
 - Memorandumin e Mirëkuptimi (MeM) për të koordinuar aktivitete për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë, si hap i parë për integritet rajonale të tregut të energjisë, nënshkruar në 2014 nga Ministrinë përkatëse të Kosovës dhe Shqipërisë;
 - Memorandumin e Mirëkuptimit të Ballkanit Perendimor 6, të nënshkruar në Vjenë me 27 prill 2016 për Zhvillimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike, nënshkruar nga Shqipëria dhe që Kosova ka shprehur gadishmëri për ta zbatuar;
 - Memorandumin e Mirëkuptimit për Themelimin dhe Funksionalizimin e Bursës së Energjisë Elektrike, nënshkruar në nëntor 2017 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës;
 - Marrëveshje Kornizë për Bashkimin e Tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, të nënshkruar me 21 tetor 2021, ndërmjet ZRRE, ERE, KOSTT dhe OST;



- o Si rezultat i një procesi të përshkruar më lartë, ZRRE në Dhjetor 2020 me Vendimin nr.1332_2020, ka Aprovuar në Parim kërkesën e OT/KOSTT SH.A për Transferim tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX) të disa të drejtave dhe përgjegjësi që kanë të bëjnë me organizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike një ditë para dhe brenda ditës. Në pikën V të dispozitivit të këtij Vendimi është përcaktuar që pas finalizimit dhe nënshkrimit të Marrëveshjes për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT SH.A. tek ALPEX, KOSTT ti drejtohet Bordit të ZRRE me kërkesë formale që të aprovoj këtë transfer.
- o ZRRE pas analizimit dhe vlerësimit të Kërkesës së Operatorit të Tregut/KOSTT sh.a. për të transferuar të drejtave dhe detyrimeve për organizimin e tregut një ditë para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimit përfundimtar për territorin e Republikës së Kosovës tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX), si dhe vlerësimit të Marrëveshjeve dhe tërë këtij procesi, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, në mbledhjen e përbashkët të Bordit të ZRRE dhe Bordit të ERE të mbajtur me datë 27.12.2022, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

II. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi i dërgohet:

OT/KOSTT SH.A
Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX).
Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Ejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfiye Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar